

ACC- ja (Asociacioni për kolegje të bashkësive) përfundon:

Një qind të ri nga pothuaj të gjitha shtetet evropiane përmbajnë me plot entuzijazëm inisiativën që "Forma e shkollave të bashkësive në vendet nordike, duhet marrë si model për zhvillimin e kolegjeve evropiane të bashkësive". Kjo njëherit edhe ishte përfundimi nga konferenca tre ditore e cila u mbajt prej 26- 28 korrik në Aabenraa të Danimarkës. *Unitet në shumëllojshmëri dhe qytetari aktive* ishin disa nga temat e diskutimeve të cilat u realizuan gjatë zhvillimit të vizionit të kësaj konference.

Në të njëjtën kohë, u evidentua edhe një dozë skepse, kur bie fjala për një jetësim të këtij vizioni. Kjo qe e evidente posaçërisht mes pjesëmarrësve që vinin nga vendet në të cilat nuk ekziston sistem i shkollave të bashkësive, i njëjtë me atë të vendeve nordike. Në shumë vende, mungesa e njohurive për sistemin e edukimit joformal vërteton parashikimet se në vitet e ardhme sektori civil dhe organizatat joqeveritare kanë një detyrë të madhe për të realizuar. Kjo në veçanti paraqitet atëherë kur duhet të realizohen konceptet për qytetari evropiane dhe zhvillim i një dialogu të përbashkët evropian, shmangies së shmangies së eksklusionit shoqëror që mund të paraqitet gjatë fazave të integritimit evropian, krijimit të kushteve për një veprim të këtillë, dhe dëshira për tu inkuadruar në procesin e debatimit dhe gjetjes së zgjidhjeve për problemet e përbashkëta.

Shkollat e bashkësive/ kolegjet e bashkësive janë institucione për edukim joformal të të rriturve të cilat funksionojnë si shkolla me konvikt.

Konferenca "Vizione për Evropën dhe demokracinë evropiane. Dialog inter- kulturor në kuadër të edukimit joformal." ishte e organizuar nga Asociacioni i shkollave daneze të bashkësive (FFD), Højskolen Østersøen dhe Asociacionit për kolegje të bashkësive (ACC).

Aabenraa 28.7.2000 /Mjellma Mehmeti + John Petersen

Për më shumë, vizitoni: